

Bazuar në nenin 158-s pika 1) në lidhje me nenin 66 paragrafi (2), nenin 129 paragrafi (2), (3) dhe (4) dhe nenin 134-zh paragrafi (3), (4) dhe (5) nga Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 188/2013, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016 dhe 83/2018) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.101/2019), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve në seancën e mbajtur më 7.11.2019 miratoi:

R R E G U L L O R E

për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e pëlqimeve

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore përshkruan mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin që parashtrohet së bashku me Kërkesën për marrje të pëlqimeve në vijim, nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve (në tekstin e mëtejme Agjencia), në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit (në tekstin e mëtejme: Ligji):

- pëlqim për ndryshim të Statutit të Shoqërisë të Sigurimeve;
- pëlqim për kryerjen e funksionit anëtar i organit të menaxhimit në Shoqëri të Sigurimeve;
- pëlqim për ndryshim të emrtimit të Shoqërisë të Sigurimeve;
- pëlqim për ndryshim të selisë të Shoqërisë të Sigurimeve;
- pëlqim për Shoqëri për Auditim;
- pëlqim për kryerje të aktiviteteve të Përfaqësimit në Sigurime nga Banka; dhe
- pëlqim për investim deri në 10% të kapitalit të Shoqërisë të Sigurimeve në një shtet anëtar të OECD ose një shtet anëtar të Bashkimit Evropian.

II. DHËNIA E PËRLQIMIT PËR NDRYSHIM TË STATUTIT TË SHOQËRISË TË SIGURIMEVE

Neni 2

(1) Për marrje të pëlqimit për ndryshim të Statutit të Shoqërisë të Sigurimeve, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për marrje të pëlqimit për ndryshim të Statutit.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet vetëm në formularin e përcaktuar: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për ndryshim të Statutit-(Formulari KP-Statut)", i cili është paraqitur në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Së bashku me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, Shoqëria e Sigurimeve parashtron dokumentacionin vijues:

1. Vendim i Asamblesë të Shoqërisë të Sigurimeve për ndryshim të Statutit të Shoqërisë, i cili detyrimisht duhet të përmbajë një dispozitë sipas së cilës, i njëjti do të hyjë në fuqi pasi të marrë pëlqimin nga Agjencia apo Propozim-vendim të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve, i cili detyrimisht duhet të përmbajë një dispozitë sipas të cilës, i njëjti do të hyjë në fuqi në ditën e marrjes së pëlqimit nga Agjencia dhe miratimit të tij nga Kuvendi. Vendimi për ndryshim të Statutit duhet të përmbajë ndryshimet e propozuara të Statutit të Shoqërisë dhe shpjegim të arsyeve për ndryshim të Statutit të Shoqërisë.
2. Statutin ekzistues të Shoqërisë, të arkivuar dhe nënshkruar nga Organi Drejtues kompetent i Shoqërisë;

3. Propozim tekst të konsoliduar të Statutit, në të cilin do të theksohen ndryshimet për të cilat kërkohet pëlqim; dhe
4. Vërtetim për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për ndryshim të Statutit të Shoqërisë të Sigurimeve, në përputhje me Tarifën e Agjencisë.

(4) Nëse ndryshimet në Statutin e Shoqërisë i referohen ndryshimit të kapitalit aksionar të Shoqërisë, ndryshimit të numrit dhe llojit të aksioneve, ndryshimit të vlerës nominale të aksioneve, dhe të ngjashme, përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (3) të këtij neni, së bashku me Kërkesën gjithashtu parashtrohet edhe Vendim për dhënien e lejes për emetim të letrave me vlerë afatgjata nga Komisioni i Letrave me Vlerë.

(5) Gjatë marrjes së vendimit lidhur me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, vlerësohet nëse ndryshimet e propozuara janë në përputhje me dispozitat ligjore.

(6) Në bazë të vlerësimit të përmendur në paragrafin (5) të këtij neni, Agjencia miraton vendim për lëshim të pëlqimit për ndryshim të Statutit ekzistues të Shoqërisë ose për refuzim të Kërkesës brenda afateve të përcaktuara me ligj.

III. DHËNIA E PËLQIMIT PËR KRYERJE TË FUNKSIONIT ANËTAR I ORGANIT DREJTUES TË SHOQËRISË TË SIGURIMEVE

Neni 3

(1) Për dhënie të pëlqimit për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues (anëtar i bordit të drejtorëve dhe anëtar ekzekutiv i bordit të drejtorëve) në Shoqërinë e Sigurimeve, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për Shoqërinë e Sigurimeve.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet vetëm në formularin e përcaktuar: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues në Shoqëri të Sigurimeve (Formulari KP – Organ drejtues)" i cili është paraqitur në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet në Agjenci së paku 30 ditë para skadimit të periudhës për të cilën është dhënë pëlqim paraprak për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues nga Agjencia.

(4) Së bashku me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni Shoqëria e Sigurimeve parashtron dokumentacionin vijues:

1. Vendim të autoritetit kompetent të Shoqërisë së Sigurimeve për emërim të Anëtarit të Organit Drejtues në Shoqëri të Sigurimeve, i cili detyrimisht duhet të përmbajë dispozitë, sipas së cilës, Vendimi do të hyjë në fuqi pasi të marrë pëlqimin për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues nga Agjencia;
 2. Një kopje të dokumentit për identifikim personal;
 3. Pyetësor të plotësuar për Anëtar të Organit Drejtues të Shoqërisë së Sigurimeve në formular të përshkruar përkatës të paraqitur në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;
 4. Certifikatë/Diplomë për arsim të lartë të kryer të personit të propozuar për Anëtar të Organit Drejtues;
- Nëse personi është arsimuar jashtë vendit, së bashku me Certifikatën/Diplomën, parashtron edhe një dokument për njohje (nostrifikim) të lëshuar nga një Institucion kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

5. Vërtetim nga një Person juridik (punëdhënës) se personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues ka pesë vjet përvojë pune të suksesshme në sferën e financave ose të sigurimit, ose tre vjet përvojë pune si person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në një Shoqëri të Sigurimeve me veprimtari të përshtatshme për Shoqërinë e Sigurimeve në të cilën emërohet, në të cilin është specifikuar funksioni/pozicioni dhe periudha gjatë së cilës personi ka kryer funksionin, si dhe detyrat e punës të cilat i ka kryer personi, dhe me kërkesë të Agjencisë edhe prova të tjera shtesë (kopje të kontratave të punës, vendime, prova nga Agjencia për Punësim, Regjistri Qendror ose Institucione të tjera kompetente);
 - Konsiderohet se personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues ka pesë vjet përvojë pune të suksesshme në fushën e financave ose të sigurimit, nëse personi pas kryerjes së arsimit të lartë, të paktën 5 vjet ka kryer detyra dhe funksione në një Shoqëri të Sigurimeve, Bankë dhe Institucion tjetër Financiar, Organ Përgjegjës për Mbikëqyrje të Institucioneve Financiare, si dhe në një Shoqëri Tregtare/Person dhe Organ Juridik gjegjësisht Organ të Administratës Shtetërore, veprimtaria kryesore e të cilit është kryerja e punëve financiare ku personi ka pasur një shkallë të lartë të kompleksitetit dhe autonomisë në kryerjen e detyrave dhe për të cilat Agjencia konsideron se ato janë të një natyre të tillë që nëpërmjet kryerjes së atyre punëve personi ka fituar përvojën e nevojshme për Kryerje të Funksionit Anëtar i Organit Drejtues në Shoqërinë e Sigurimeve.
 - Konsiderohet se personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues ka tre vjet përvojë pune si person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në Shoqëri të Sigurimeve me veprimtari të përshtatshme për Shoqërinë e Sigurimeve në të cilën emërohet, nëse personi pas mbarimit të arsimit të lartë të paktën 3 vjet ka punuar si:
 - Anëtar i një Organi Drejtues ose Anëtar i një Organi Mbikëqyrës në Shoqëri të Sigurimeve;
 - Shef i Departamentit, Drejtorisë, Shërbimit ose të ndonjë forme tjetër organizative në kuadër të një Shoqërie të Sigurimeve.
6. Vërtetim nga Regjistri Qendror ose regjistër tjetër publik ku personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve është Anëtar i një Organi Drejtues, Organi për Mbikëqyrje, Prokurist ose Person me të Drejta dhe Përgjegjësi të Veçanta në Persona të tjerë Juridikë;
7. Vërtetim nga Regjistri Qendror ose regjistër tjetër publik se ndaj personit nuk janë shqiptuar sanksione kundërvajtëse ose ndëshkim ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimit dhe financave;
8. Vërtetim nga Evidenca Ndëshkimore e Gjykatës Kompetente se Personi Fizik nuk është dënuar me Aktgjykim Gjyqësor të formës së prerë me burgim të pakushtëzuar për më shumë se gjashtë muaj për vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, vepra penale kundër detyrës zyrtare, si dhe vepra penale falsifikim të dokumenteve, falsifikim kompjuterik, përdorim të dokumentit me përmbajtje të pasaktë dhe pseudosekretari nga Kodi Penal, për sa kohë që pasojat juridike të aktgjyqimit janë në fuqi;
9. Deklaratë nga personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues se nuk ka kryer funksion të personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në një Shoqëri të Sigurimeve ose në një Person tjetër Juridik, në të cilën/cilin është krijuar një administratë e veçantë ose mbi të cilën është hapur procedurë falimentimi ose likuidimi;
10. Deklaratë nga personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues se nuk është person i lidhur me një person juridik në të cilin Shoqëria e Sigurimeve zotëron drejtpërdrejt apo tërthorazi më shumë se 10% të kapitalit ose të drejtave të votës në atë person juridik;
11. Vërtetim nga Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë gjegjësisht një regjistër tjetër publik për atë se ku personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues mban aksione në persona të tjerë juridikë;
12. Vërtetim nga Regjistri Qendror ose një regjistër tjetër publik, për atë se ku personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues mban aksione në persona të tjerë juridikë;

13. Deklaratë nga personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues se nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit;
14. Kontratë pune si Anëtar i Organit Drejtues (kontratë menaxheriale) të lidhur midis Organit Mbikëqyrës të Shoqërisë të Sigurimeve dhe personit të propozuar për Anëtar të Organit Drejtues dhe Formularë M1/M2, nëse personi në momentin e paraqitjes së Kërkesës kryen funksionin Anëtar i Organit Drejtues në Shoqërinë për Sigurime në bazë të një pëlqimi paraprak nga Agjencia;
- Nëse personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues nuk është i punësuar në Shoqërinë e Sigurimeve si Anëtar i Organit Drejtues, si dhe në rast se Shoqëria e Sigurimeve është në procedurë për marrje të lejes për kryerje të punëve të sigurimit, parashtrohet Deklaratë e Organit Mbikëqyrës të Shoqërisë të Sigurimeve gjegjësisht Deklaratë e themeluesve/aksionarëve të Shoqërisë të Sigurimeve se personi do të jetë në marrëdhënie të përhershme pune në Shoqërinë e Sigurimeve si Anëtar i Organit Drejtues të Shoqërisë pas marrjes së pëlqimit nga Agjencia gjegjësisht pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
15. Koncept për administrim të Shoqërisë për Sigurime të hartuar nga Anëtari i propozuar i Organit Drejtues për periudhën për të cilën personi emërohet për Anëtar të Organit Drejtues. Koncepti duhet të përfshijë të paktën kapitujt në vijim:
- Përshkrim të situatës në të cilën gjendet Shoqëria e Sigurimeve në të cilën personi është i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues duke përfshirë përshkrimin e mjedisit në të cilin punon shoqëria dhe vendin dhe rolin e asaj Shoqërie në tregun e sigurimit (duhet të theksohen pikat e forta dhe të dobëta të Shoqërisë për sa i përket konkurrencës);
 - Përshkrim të aktiviteteve të planifikuara për periudhën për të cilën personi propozohet për Anëtar të Organit Drejtues, përfshirë ndryshime të rëndësishme të planifikuara sa i përket situatës ekzistuese në Shoqëri;
 - Përshkrim të aktiviteteve që do të ndërmerren për të mbështetur aktivitetet e planifikuara në mënyrë që të identifikojë, monitorojë, mat dhe menaxhojë me kohë dhe në mënyrë cilësore të gjitha rreziqet që mund të vijnë nga aktivitetet e planifikuara;
 - Përshkrim të rreziqeve ndaj të cilave Shoqëria është dhe mund të jetë e ekspozuar gjatë kryerjes së aktiviteteve të planifikuara me përshkrim të sistemit të menaxhimit të tyre;
 - Përshkrim të politikës së paraparë për parandalim të konflikteve të interesave;
 - Plan për veprim të Shoqërisë në rast të paaftësisë paguese dhe jolikuiditetit të Shoqërisë;
 - Përshkrim të funksioneve kryesore të Shoqërisë;
 - Përmbledhje të masave për mbikëqyrje të cilat Agjencia eventualisht mund të ketë ndërmarrë ndaj Shoqërisë dhe veprimet që ndërmerren për adresimin e tyre;
 - Projektion të pasqyrave financiare të Shoqërisë për periudhën për të cilën personi emërohet për Anëtar të Organit Drejtues (në formularë të përshkruar në pajtim me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për punën e shoqërive të Sigurimeve dhe/ose Risigurimeve si dhe projektion të lëvizjes në nivelin e kërkuar të marzhit të aftësisë paguese, kapitalit të nevojshëm, provigjoneve teknike dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike;
16. Vendim të Organit për Mbikëqyrje të Shoqërisë për aprovim të Konceptit për Menaxhim të Shoqërisë;
17. Nëse personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të parashtrohet:
- leje e vlefshme për qëndrim të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
 - leje e vlefshme për qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (nëse në Shoqërinë e Sigurimeve nuk ka Anëtar tjetër të Organit Drejtues që ka vendbanimin apo qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut);

- Vërtetim për njohje aktive të gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik të lëshuar nga Fakulteti i Filologjisë pranë Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi - Departamenti i gjuhës maqedonase dhe gjuhëve sllave të jugut (nëse në Shoqërinë e Sigurimeve nuk ka Anëtar tjetër të Organit Drejtues që e njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik).

18. Vërtetim për kompensim të paguar për dhënien e pëlqimit për kryerje të funksionit të Anëtarit të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve, në përputhje me Tarifën e Agjencisë.

(5) Përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (4) të këtij neni, Agjencia sipas detyrës zyrtare, nga evidenca e saj përcakton se personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues të Shoqërisë nuk është Anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë dhe që Agjencia me vendim nuk ka refuzuar të lëshojë pëlqim për kryerje të funksionit Anëtar të Organit Drejtues në lidhje me personin e propozuar për Anëtar të Organit Drejtues për të paktën një vit nga data e miratimit të vendimit për refuzim të Kërkesës.

(6) Dokumentacionin nga paragrafi (4) pikat 6, 7, 11 dhe 12 të këtij neni, sipas detyrës zyrtare Agjencia do ta marrë nga autoriteti publik kompetent (nëse të njëjtin nuk e ka parashtruar aplikuesi), për të cilin aplikuesi si dhe personat e propozuar për kryerje të funksionit Anëtarë të Organit Drejtues të Shoqërisë do të japin deklaratë me të cilën e autorizojnë Agjencinë në emër dhe për llogari të saj të përdorë të dhënat e përfshira në Formularin K-POD (Deklarata është pjesë përbërëse e Formularit K-POD) të paraqitur në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje dhe në Agjenci dorëzon dëshmi për pagesë të kryer në llogari të institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit përkatës në shumën e përcaktuar me Tarifën e përcaktuar në pajtim me ligjin."

(7) Certifikatën nga paragrafi (4) pika 8 e këtij neni, sipas detyrës zyrtare Agjencia e merr nga gjykata kompetente (nëse të njëjtin nuk e ka parashtruar aplikuesi). Nëse personi është person i huaj, është i detyruar vetë të sigurojë njoftimet e tilla nga Institucionet kompetente në shtetin e huaj.

(8) Përveç dokumentacionit të përcaktuar në paragrafin (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni, në mënyrë plotësuese Agjencia mund të kërkojë edhe dokumentacion tjetër, gjatë procesit të vendosjes nëse personi i propozuar i plotëson kriteret e përcaktuara në Ligj.

(9) Me anëtarin e propozuar të organit drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve, Agjencia do të zhvillojë intervistë me qëllim të vlerësimit të:

- njohurive mbi rregullat e sigurimit dhe/ose financave;
- njohurive për Shoqërinë e Sigurimeve në të cilën është i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues, të kuptuarit të përgjegjësisë dhe kompetencave të Organit Drejtues, njohjes së rreziqeve dhe mënyrave dhe teknikave për menaxhim me të njëjtat, njohjes së proceseve të biznesit në kompani, aftësisë për organizim të punës së Shoqërisë si dhe gatishmërisë për mësim të vazhdueshëm dhe zhvillim profesional.

(10) Në intervistën nga paragrafi (9) i këtij neni, personi duhet të prezantojë edhe Konceptin e paraqitur për menaxhim të Shoqërisë.

(11) Intervistën nga paragrafi (9) i këtij neni e zhvillon Komisioni i themeluar nga Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë i cili, pas realizimit të intervistës, jep një mendim për personin e propozuar për Kryerje të Funksionit Anëtar i Organit Drejtues në Shoqëri të Sigurimeve. Mendimi është pjesë përbërëse e dokumentacionit në bazë të të cilit merret vendimi mbi Kërkesën.

(12) Gjatë marrjes së vendimit mbi Kërkesën në bazë të dokumentacionit të parashtruar dhe intervistës së realizuar, Agjencia vlerëson nëse Anëtari i propozuar i Organit Drejtues i përmbush kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit, gjegjësisht nëse ai ka arsim dhe kompetencë përkatëse për Kryerje të Funksionit Anëtar i Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve; nëse ka përvojë përkatëse; nëse i njeh

dispozitat nga fusha e sigurimit si dhe nëse i plotëson kushtet e tjera të ligjit me të cilët do të sigurojë punë të sigurtë dhe të qëndrueshme të Shoqërisë.

(13) Njohja e dispozitave nga fusha e sigurimit dhe/ose financave nënkupton njohje të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit, Ligjit për Sigurimin e Obligueshëm në Komunikacion, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtyre ligjeve, rregulloreve dhe praktikave të tjera të cilat janë të rëndësishme për funksionimin e Shoqërisë, nga pikëpamja e punëve të sigurimit të cilat i kryen Shoqëria në të cilën personi është i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues si dhe karakteristikat dhe lëvizjet në sektorin e sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(14) Nëse personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues më parë ka qenë anëtar i një Organi Drejtues në një Shoqëri tjetër të sigurimit, vlerësohet nëse personi ka shkelur dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit, Ligjit për Sigurim të detyrueshëm në Komunikacion dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtyre ligjeve dhe/ose nuk ka respektuar masat e vendosura nga Agjencia, me të cilat është ose ka qenë e rrezikuar siguria dhe stabiliteti i Shoqërisë të Sigurimeve.

(15) Nëse anëtari i propozuar i Organit Drejtues është person i huaj, të dhënat përkatëse për të vërtetuar përvojën dhe reputacionin e tij mund të kërkohen nga Autoriteti Mbikëqyrës i vendit nga i cili vjen.

(16) Në bazë të vlerësimit nga paragrafi (12) i këtij neni, Agjencia miraton vendim për dhënie të Pëlqimit për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues ose për refuzim të Kërkesës, brenda afateve kohore të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit.

(17) Agjencia do të lëshojë pëlqim për Anëtarin e propozuar të Organit Drejtues për periudhën në të cilën Anëtari i propozuar i Organit Drejtues të përcaktuar në Vendimin për emërim të tij, të miratuar nga Organi kompetent i Shoqërisë.

(18) Pavarësisht nga paragrafi (17) i këtij neni, Agjencia do të lëshojë pëlqim për Anëtarin e propozuar të Organit Drejtues me afat më të shkurtër se afati i parashikuar në Vendimin për emërim të Anëtarëve të Organit Drejtues, Statutin e Shoqërisë gjegjësisht Ligjin për Shoqëri Tregtare nëse Agjencia e vlerëson si të nevojshme.

(19) Së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për riemërim të personit i cili ka marrë pëlqim për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues i Shoqërisë të Sigurimeve (rizgjedhje), Shoqëria parashtron dokumentacionin nga paragrafi (4) i këtij neni, përveç dokumentacionit të përmendur në pikat 4 dhe 5.

(20) Pas dhënies së pëlqimit për Kryerje të Funkcionit Anëtar të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve, Shoqëria e Sigurimeve është e detyruar të parashtojë në Agjenci:

- Vendim për regjistrim të kryer të personit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vendimi parashtrohet në afat prej 5 ditëve të punës nga data e regjistrimit të kryer;
- Vërtetim se personi ka vendosur marrëdhënie pune të përhershme në Shoqërinë e Sigurimeve si Anëtar i Organit Drejtues në Shoqërinë e Sigurimeve.

IV. DHËNIA E PËLQIMIT PËR NDRYSHIM TË EMËRTIMIT TË SHOQËRISË TË SIGURIMEVE

Neni 4

(1) Për dhënie të pëlqimit për ndryshim të emërtimit të Shoqërisë të Sigurimeve, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për marrje të pëlqimit për ndryshim të emërtimit.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet vetëm në formularin e përcaktuar: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për ndryshim të emërimit (Formulari KP-Emërtim)" i cili është paraqitur në Shtojcën 4 të kësaj Rregullore dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Së bashku me Kërkesën e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, Shoqëria e Sigurimeve parashton Vendim për ndryshim të emërimit të Shoqërisë të miratuar nga Organi Drejtues kompetent i Shoqërisë të Sigurimeve, i cili detyrimit duhet të përmbajë një dispozitë, sipas të cilës i njëjti do të hyjë në fuqi pas marrjes së pëlqimit nga Agjencia dhe dëshmi për pagesë të kompensimit për dhënie të pëlqimit për ndryshim të emërimit të Shoqërisë të Sigurimeve, në përputhje me Tarifën e Agjencisë. Vendimi poashtu detyrimisht duhet të përfshijë edhe Shpjegim për nevojën dhe qëllimin e ndryshimit të tillë.

(4) Gjatë analizës së Kërkesës bëhet kujdes që me emërtimin e ri të Shoqërisë mos të krijohet mundësi për konfuzion në lidhje me identitetin e ndonjë shoqërie ekzistuese të sigurimeve ose subjekteve të tjera që veprojnë në tregun e sigurimit, si dhe konfuzion në lidhje me identitetin dhe volumin e aktiviteteve të Shoqërisë e cila kërkon ndryshim të emërimit.

(5) Ndaj Kërkesës për ndryshim të emërimit të Shoqërisë të Sigurimeve, Agjencia miraton vendim për dhënie të pëlqimit ose refuzim të Kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve.

(6) Pas marrjes së pëlqimit nga Agjencia, Shoqëria e publikon ndryshimin e emërimit të Shoqërisë në një gazetë ditore për të paktën tre ditë radhazi. Provë për shpalljen e publikuar parashtrohet në Agjenci në afat prej pesë ditëve nga publikimi i saj në gazetën ditore.

(7) Paralelisht me Kërkesën për marrje të pëlqimit për ndryshim të emërimit të Shoqërisë të Sigurimeve, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për ndryshim të Statutit të Shoqërisë të Sigurimeve, në pjesën e emërimit së bashku me dokumentacionin e parashikuar në nenin 2 të kësaj rregullore.

V. DHËNIA E PËLQIMIT PËR NDRYSHIM TË SELISË TË SHOQËRISË TË SIGURIMEVE

Neni 5

(1) Për dhënie të pëlqimit për ndryshim të selisë të Shoqërisë të Sigurimeve, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për dhënie të pëlqimit për ndryshim të selisë.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht parashtrohet vetëm në formularin e përcaktuar: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për ndryshim të selisë (Formulari KP-Seli)" i cili është paraqitur në Shtojcën 5 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Së bashku me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, Shoqëria e Sigurimeve parashton Vendim për ndryshim të selisë të Shoqërisë të miratuar nga Organi Drejtues kompetent i Shoqërisë të Sigurimeve i cili detyrimisht përmban një dispozitë, sipas të cilës, i njëjti do të hyjë në fuqi pas marrjes së pëlqimit nga Agjencia dhe dëshmi për pagesë të kompensimit për dhënie të pëlqimit për ndryshim të emërimit dhe/ose selisë të Shoqërisë të Sigurimeve, në përputhje me Tarifën e Agjencisë. Vendimi detyrimisht duhet të përmbajë Shpjegim për nevojën dhe qëllimin e ndryshimit të tillë.

(4) Së bashku me Kërkesën për ndryshim të selisë të Shoqërisë parashtrohen edhe të dhëna dhe dokumente për hapësirat afariste ku do të vendoset selia e re (në zotërim ose me qira, vendndodhja, sipërfaqja, dhe të ngjashme) dhe për njësitë organizative të Shoqërisë të cilat do të funksionojnë në selinë e re.

(5) Agjencia mund të kryejë verifikim të selisë në kuptim të përmbushjes së nivelit të kërkuar të pajisjeve teknike dhe përshtatshmërisë së selisë për kryerje normale të punëve të sigurimit.

(6) Ndaj Kërkesës për ndryshim të selisë të Shoqërisë të Sigurimeve, Agjencia miraton vendim për dhënie të pëlqimit ose për refuzim të Kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit.

(7) Pas marrjes së pëlqimit nga Agjencia, Shoqëria e publikon ndryshimin e selisë të Shoqërisë në një gazetë ditore për të paktën tre ditë radhazi. Provë për shpalljen e publikuar parashtrohet në Agjenci në afat prej pesë ditëve nga dita e botimit të saj në gazetën ditore.

(8) Paralelisht me Kërkesën për marrje të pëlqimit për ndryshim të selisë të Shoqërisë të Sigurimeve, në Agjenci parashtrohet edhe Kërkesë për ndryshim të Statutit të Shoqërisë në pjesën e selisë së bashku me dokumentacionin e parashikuar në nenin 2 të kësaj rregulloreje.

VI. DHËNIA E PËLQIMIT PËR SHOQËRI PËR AUDITIM

Neni 6

(1) Për marrje të pëlqimit për shoqëri për auditim, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për marrje të pëlqimit për shoqëri për auditim.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet vetëm në formularin e përcaktuar: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për shoqëri për auditim (Formulari KP-Shoqëri për auditim)", i cili është paraqitur në Shtojcën 6 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Së bashku me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, Shoqëria e Sigurimeve parashtron dokumentacionin vijues:

1. Vendim të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë të Sigurimeve për përcaktim të Shoqërisë për Auditim e cila do të kryejë auditim të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë, i cili detyrimisht duhet të përmbajë një dispozitë sipas të cilës, i njëjti do të hyjë në fuqi pasi të marrë pëlqimin nga Agjencia.
2. Deklaratë të Organit Drejtues kompetent të Shoqërisë të Sigurimeve se Shoqëria e Sigurimeve nuk është person i lidhur me Shoqërinë për Auditim, se Shoqëria e Sigurimeve në tre vitet e fundit nuk ka pranuar asnjë lloj shërbimi këshillues nga Shoqëria për Auditim dhe se Shoqëria për Auditim nuk ka kryer pesë auditime të njëpasnjëshme të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të Sigurimeve;
3. Deklaratë të personit të autorizuar të Shoqërisë për Auditim se Shoqëria për Auditim ka më shumë se tre vjet përvojë në kryerje të auditimit, se Shoqëria për Auditim nuk është person i lidhur me Shoqërinë e Sigurimeve në kuptim të dispozitave të Ligjit për Auditim, se Shoqëria për Auditim në tre vitet e fundit nuk i ka dhënë kurrfarë shërbime këshilluese Shoqërisë të Sigurimeve, se Shoqëria për Auditim nuk ka kryer pesë auditime të njëpasnjëshme të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të Sigurimeve; dhe
4. Vërtetim nga Instituti i Auditorëve të Autorizuar gjegjësisht Këshilli për Avancim dhe Mbikëqyrje të Auditimit se Shoqërisë për Auditim në tre vitet e fundit nuk i janë shqiptuar masa nga Instituti i Auditorëve të Autorizuar gjegjësisht nga Këshilli për Avancim dhe Mbikëqyrje të Auditimit;
5. Dëshmi për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për Shoqëri për Auditim, në përputhje me Tarifën e Agjencisë

(4) Gjatë marrjes së vendimit për Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, vlerësohet nëse Shoqëria për Auditim përmbush kushtet në përputhje me Ligjin.

(5) Bazuar në vlerësimin nga paragrafi (4) i këtij neni, Agjencia miraton vendim për dhënie të pëlqimit për Shoqëri për Auditim ose për refuzim të Kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligj.

VII. DHËNIA E PËLQIMIT PËR KRYERJE TË AKTIVITETEVE TË PËRFAQËSIMIT NË SIGURIM NGA BANKA

Neni 7

(1) Për marrje të pëlqimit për kryerje të punëve të përfaqësimit nga banka, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për marrje të pëlqimit për kryerje të punëve të përfaqësimit nga banka.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet vetëm në formularin e përcaktuar: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurim nga banka në Formular KA-Përfaqësim nga banka)", i cili është paraqitur në Shtojcën 7 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Së bashku me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, banka parashton dokumentacionin vijues:

1. Vendim të Organit kompetent të Bankës për fillim të kryerjes së punëve të përfaqësimit në sigurim;
2. Vendim/leje për themelim dhe punë të bankës të lëshuar nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
3. Certifikatë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Gjendja aktuale për bankën;
4. Deklaratë të Organit kompetent të Bankës se Banka nuk është e lidhur me kapital apo menaxhim me Shoqëri për Përfaqësim në Sigurime apo Shoqëri Brokerimi në Sigurime në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve;
5. Deklaratë të Organit kompetent të Bankës se Banka nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
6. Raport për auditim nga një Shoqëri e Autorizuar për Auditim për dy vitet e fundit të biznesit për bankën;
7. Baza të politikës të biznesit të bankës me shpjegime, gjegjësisht analizë të arsyeve për fillim të kryerjes së punëve të përfaqësimit në sigurime, objektivat e biznesit të bankës dhe pasqyrë të tregut në të cilin do të marrë pjesë banka, strukturën e klientëve të bankës, etj.;
8. Elaborat me projeksion të rezultateve të pritura të biznesit të bankës për kryerjen e punëve të përfaqësimit në sigurim për një periudhë të paktën trevjeçare;
9. Tarifë për shërbime të kryera të bankës në fushën e kryerjes së punëve të përfaqësimit në sigurime;
10. Dokumentacion, në bazë të të cilit mund të konstatohet se banka është e aftësuar me staf, teknikë dhe e organizuar të kryejë aktivitetet të përfaqësimit në sigurime, duke përfshirë edhe një ekstrakt nga Akti i Sistematizimit të Vendeve të Punës në Bankë, si dëshmi se banka ka siguruar pozicione të përshtatshme pune për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurime për të cilët si parakusht kërkohet zotërimi i një certifikate për përfaqësues në sigurime;
11. Akte të politikës së biznesit të bankës të cilët rregullojnë mënyrën e kryerjes së punëve të përfaqësimit në sigurim, në veçanti: mënyrën e mbajtjes dhe përmbajtjes së evidencës së policave për sigurime, trajtimit të formularëve të evidencës së rreptë (sipas klasave të sigurimit), volumin e dhënies së informacionit kontraktuesve në sigurim gjegjësisht siguresve në përputhje me ligjin, volumin dhe mënyrën e mbledhjes, ruajtjes dhe paraqitjes së të dhënave në lidhje me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara me Ligjin me të cilin rregullohet parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, detyrimet e bankës për transferim të fondeve të mbledhura nga kontraktuesit ose siguresit në dobi të Shoqërisë të Sigurimeve brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjen me Shoqërinë, mënyrën e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me kontraktuesit gjegjësisht siguresit, etj;

12. Vendim të Organit kompetent të Bankës për përcaktim të personit/ave i/të cili/ët do të jetë/në person përgjegjës në bankë në pjesën e kryerjes të punëve të përfaqësimit në sigurim me të dhëna për personin dhe prova se personi përmbush kërkesat e Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit siç është: certifikatë për përfaqësim në sigurime, kontratë pune dhe formularë M1/M2;
13. Paramarrëveshje apo Marrëveshje për Sigurime nga Përgjegjësia të lidhur me një Shoqëri të Autorizuar të Sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Paramarrëveshja/Marrëveshja duhet të lidhet me një Shoqëri të Sigurimeve me të cilën nuk është lidhur Marrëveshja për Përfaqësim në Sigurime;
14. Marrëveshje për përfaqësim në sigurim të lidhur midis Bankës dhe Shoqërisë të sigurimeve për të cilën banka do të kryejë punë të përfaqësimit në sigurim (me tregues të detyrueshëm të klasave të sigurimit për të cilat banka është e autorizuar nga Shoqëria e Sigurimeve të kryejë aktivitete të përfaqësimit në sigurime për shoqërinë e sigurimeve dhe dispozitë sipas të cilës Shoqëria e Sigurimeve është përgjegjëse për punën e bankës në pjesën e kryerjes të punëve të sigurimit në pajtim me marrëveshjen e lidhur për sigurime);
15. Deklaratë të personit të autorizuar të bankës se banka do të kryejë punë të përfaqësimit në sigurim në pajtim me Marrëveshjen/et për përfaqësim në sigurim për një Shoqëri të Sigurimeve apo eventualisht për më shumë Shoqëri të Sigurimeve për produkte të sigurimit jo konkurrues;
16. Deklaratë të personit të autorizuar të bankës se banka do t'i parashtrrojë Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit të dhënat e përcaktuara në nenin 151 të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit dhe të gjitha të dhënat e tjera me kërkesë të Agjencisë;
17. Dëshmi për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurime nga banka, në pajtim me Tarifën e Agjencisë;
18. Dokumentacion tjetër me kërkesë të Agjencisë.

(4) Gjatë marrjes së vendimit për Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, vlerësohet nëse banka i plotëson kushtet për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurim, në pajtim me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimit.

(5) Në bazë të vlerësimit nga paragrafi (4) i këtij neni, Agjencia miraton vendim për dhënie të pëlqimit për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurim nga banka ose për refuzim të Kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me ligj.

VIII. PËLQIM PËR INVESTIM DERI NË 10% NGA KAPITALI I SHOQËRISË TË SIGURIMEVE NË NJË VEND ANËTAR TË OECD APO NË NJË VEND ANËTAR TË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 8

(1) Për marrje të pëlqimit për investim të Shoqërisë të Sigurimeve deri në 10% të kapitalit të Shoqërisë të Sigurimeve në një vend anëtar të OECD-së ose në një vend anëtar të Bashkimit Europian, në Agjenci parashtrohet Kërkesë për investim të Shoqërisë të Sigurimeve deri në 10% të kapitalit të Shoqërisë të Sigurimeve në një vend anëtar të OECD-së ose në një vend anëtar të Bashkimit Europian.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrje të pëlqimit për investim të Shoqërisë të Sigurimeve deri në 10% të kapitalit të Shoqërisë të Sigurimeve në një vend anëtar të OECD-së ose në një vend anëtar të Bashkimit Europian. (Formular KP-OECD/BE) " i cili është paraqitur në Shtojcën 8 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Së bashku me Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, Shoqëria e Sigurimeve parashtron Vendim të Organit kompetent të Shoqërisë të Sigurimeve në të cilin shënohet qëllimi i Shoqërisë të Sigurimeve për investim në një vend anëtar të OECD-së ose në një vend anëtar të Bashkimit Europian, llojin dhe sasinë e investimit si dhe shpjegim të arsyeve, qëllimit dhe arsyetimit të investimit dhe Deklaratë të Organit kompetent të Shoqërisë të Sigurimeve se me investim në një vend anëtar të OECD ose në një vend anëtar të Bashkimit Europian nuk shkel rregullat e menaxhimit të rrezikut.

(4) Në varësi të llojit të investimit, në procedurën e vendimmarrjes Agjencia mund të kërkojë nga Shoqëria e Sigurimeve edhe të dhëna dhe dokumente të tjera nga të cilat mund të përcaktohet lloji dhe vlera e investimit, mundësia e zotërimit të tregut të lirë me investimin si dhe nëse investimi do të rrezikojë cilësinë, sigurinë dhe likuiditetin e totalit të aktiveve të Shoqërisë të Sigurimeve.

(5) Gjatë marrjes së vendimit në bazë të dokumentacionit nga paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të këtij neni, Agjencia vlerëson ndikimin që do të ketë investimi në funksionimin e përgjithshëm të Shoqërisë të Sigurimeve për sa i përket punës së sigurt dhe të qëndrueshme të saj.

(6) Në bazë të vlerësimit nga paragrafi (5) i këtij neni, Agjencia miraton vendim për dhënie të pëlqimit për investim deri në 10% të kapitalit të Shoqërisë të Sigurimeve në një vend anëtar të OECD-së ose në një vend anëtar të Bashkimit Europian apo miraton vendim për refuzim të Kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me ligj.

IX. SPECIFIKIMI I FORMËS SË PARAQITJES SË DOKUMENTACIONIT DHE RREGULLIMIT TË PUNËVE TË NEVOJSHME PËR ZBATIM TË RREGULLORES

Neni 9

(1) Së bashku me Kërkesat për dhënie të pëlqimeve nga neni 1 i kësaj rregulloreje, parashtrihen të dhëna për personin përgjegjës në shoqëri dhe personin përgjegjës për kontakt me Agjencinë (emri dhe mbiemri, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike).

(2) Dokumentacioni që parashtrihet së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimeve nga neni 1 i kësaj rregullore duhet të jetë origjinal apo kopje e vërtetuar nga një person i autorizuar (noter), i nënshkruar nga një person i autorizuar ose nga autoriteti kompetent përkatës, të jetë i pastër, pa korrigjime shtesë dhe në gjuhën maqedonase. Nëse dokumenti që duhet të parashtrihet është në një gjuhë tjetër, së bashku me origjinalin parashtrihet edhe përkthimi në gjuhën maqedonase, i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar dhe i vërtetuar nga një noter.

(3) Deklaratat dhe pyetësorët të cilët janë pjesë e dokumentacionit i cili parashtrihet së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit nga neni 1 i kësaj rregulloreje duhet të vërtetohen nga një person i autorizuar (noter) dhe ato nuk duhet të jenë më të vjetër se gjashtë muaj para datës së paraqitjes së Kërkesës për dhënie të pëlqimit.

(4) Nëse legjislacioni i vendit të origjinës së personit të huaj e rregullon ndryshe çështjen në lidhje me dokumentacionin e parashtruar së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit nga neni 1 i kësaj rregullore, duhet të parashtrihet një dokument i duhur, apo mendim juridik nga një avokat, me të cilin mund të konfirmohet dallimi në rregullore, gjegjësisht do të sigurohet një dokument tjetër përkatës me të cilin do të konfirmohet përmbushja e detyrimit të parashikuar ligjor.

(5) Agjencia e shqyrton Kërkesën për dhënie të pëlqimit nga neni 1 i kësaj rregulloreje me dokumentacionin e plotë. Dokumentacioni i plotë nënkupton dokumentacionin e përcaktuar me këtë Rregullore, dokumentacionin e kërkuar shtesë nga Agjencia, si dhe dokumentet, të dhënat dhe informatat përkatëse, që duhet të merren nga institucionet kompetente vendase dhe të huaja, për të vendosur për Kërkesën.

X. DISPOZITA KALIMTARE

Neni 10

Personat të cilët në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore kryejnë Funkcionin e Anëtarit të një Organi Drejtues të një Shoqërie të Sigurimeve, si dhe personat që do të marrin pëlqim nga Agjencia në periudhë prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore të cilët si provë për arsim të lartë të kryer kanë paraqitur Certifikatë/Diplomë të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, janë të obliguar brenda një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore të përshtaten me dispozitat nga neni 3 paragrafi (4) pika 4 e kësaj rregulloreje gjegjësisht në Agjenci të parashtrojnë dokument për njohje të Diplomës/Certifikatës, të lëshuar nga një Institucion kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

XI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11

(1) Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën (e tetë) nga shpallja e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(2) Dispozitat nga neni 3 paragrafi (4) pika 4 e kësaj rregullore në pjesën e njohjes së Diplomës/Certifikatës për arsimin të lartë të kryer të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë nga një autoritet kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut, do të fillojë të zbatohen pasi të kalojë një vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

(3) Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje nuk vlen më Rregullorja për dokumentacionin e nevojshëm për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve, në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.164/2012 dhe 152/2017).

Nr. 02-770/12

Datë: 7.11.2019

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve

Klime Poposki

Përpiloi:

Boban Stojanović

Mimoza Çkaleska Kartalova

Kontrollori: Biljana Janevska Nedellkovska



AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË SIGURIMIT

KËRKESË¹
PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR NDRYSHIM TË STATUTIT

1.	Emërtimi i shoqërisë të sigurimeve - kërkues	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.2.	Adresa e postës elektronike të personit të autorizuar për kontakt	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në nenin 2 paragrafi (3) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve” siç janë (qarkohet gjegjësisht shënohet nëse plotësohet në mënyrë elektronike):

1.	Vendim të Kuvendit të Shoqërisë të Sigurimeve për ndryshim të Statutit/Propozim-vendim të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve për ndryshim të Statutit
2.	Statutin ekzistues të Shoqërisë, të arkivuar dhe të nënshkruar nga Organi Drejtues kompetent i Shoqërisë
3.	Propozim tekst të rafinuar të Statutit në të cilin do të jenë të shënuara ndryshimet për të cilat kërkohet pëlqim
5.	Vendim të Komisionit për Letra me Vlerë për dhënie të lejes për emetim të letrave me vlerë afatgjata*
6.	Dëshmi për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për ndryshim të Statutit të Shoqërisë të Sigurimeve, në pajtim me Tarifën e Agjencisë.

Dokumenti i shënuar me (*) parashtrohet nëse ndryshimet e Statutit kanë të bëjnë me ndryshim të kapitalit aksionar të Shoqërisë, ndryshim të numrit dhe llojit të aksioneve, ndryshim të vlerës nominale të aksioneve dhe të ngjashme.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me paraqitjen e kësaj Kërkesë Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e paraqes/im së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për ndryshim të Statutit të Shoqërisë të Sigurimeve, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin e parashtruar bashkëlidhur me këtë Kërkesë, në afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur do ta njoftoj Agjencinë.

Data dhe vendi i parashtrimit

Datë ____ . ____ 20 ____ , _____

Nënshkrimi i parashtruesit të Kërkesës²

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë të Mbiqëqyrjes të Sigurimeve www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i Shoqërisë të Sigurimeve



KËRKESË¹
PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR KRYERJE TË FUNKSIONIT ANËTAR I ORGANIT DREJTUES NË SHOQËRI TË SIGURIMEVE

1.	Emërtimi i shoqërisë të sigurimeve - kërkues	
2.	Emri dhe mbiemri i personit të propozuar për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues	
2.1.	Telefoni i personit të propozuar për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues	
2.2.	Adresa e postës elektronike e personit të propozuar për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues	
3.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
3.1.	Telefoni i personit të autorizuar për kontakt me Agjencinë	
3.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar për kontakt	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në pajtim me nenin 3 paragrafi (4) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve”² edhe atë (shënohet secili dokument veçmas):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë të Mbiqëqyrjes të Sigurimeve www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Dokumentacioni nga neni 3 paragrafi (4) pikat 6, 7, 11 dhe 12 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve, sipas detyrës zyrtare Agjencia do ta marrë nga autoriteti publik kompetent (nëse të njëjtin nuk e ka parashtruar aplikuesi), për të cilin aplikuesi si dhe personat e propozuar për kryerje të funksionit Anëtar të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve jep deklaratë me të cilën e autorizojnë Agjencinë në emër dhe për llogari të saj të përdorë të dhënat e përfshira në këtë Formular dhe në Agjenci paraqet dëshmi për pagesë të kryer në llogari të institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit përkatës në shumën e përcaktuar me Tarifën e përcaktuar në pajtim me ligjin. Vërtetimin nga neni 3 paragrafi (4) pika 8 e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve, sipas detyrës zyrtare Agjencia e merr nga gjykata kompetente (nëse të njëjtin nuk e ka parashtruar aplikuesi). Nëse personi është person i huaj, është i detyruar vetë të sigurojë njoftime të tilla nga institucionet kompetente në shtetin e huaj. Agjencia sipas detyrës zyrtare, nga evidenca e saj kontrollon nëse personi i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues të Shoqërisë nuk është Anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë dhe nëse Agjencia me vendim nuk ka refuzuar të lëshojë pëlqim për kryerje të funksionit Anëtar të Organit Drejtues në lidhje me personin e propozuar për Anëtar të Organit Drejtues, edhe atë për të paktën në periudhë prej një viti pas datës së miratimit të vendimit për refuzim të kërkesës për dhënie të pëlqimit.

10. _____

11. _____

12. _____

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS DHE PERSONIT TË PROPOZUAR PËR KRYERJE TË FUNKSIONIT ANËTAR I OD

Me paraqitjen e kësaj Kërkese Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtror/më së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për Kryerje të Funkcionit Anëtar i Organit Drejtues, janë të sakta dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin e paraqitur bashkëlidhur me këtë Kërkesë, në do të njoftoj Agjencinë afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur.

Me paraqitjen e kësaj Kërkese jam dakord të dhënat e mia personale të përfshira në këtë Kërkesë të përdoren në procedurë të realizimit të të drejtës për marrje të dëshmime dhe të dhënave të nevojshme nga organe të tjera publike kompetente sipas detyrës zyrtare dhe të njëjtat të përdoren në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Data dhe vendi i parashtrimit

Nënshkrimi i parashtruesit¹

Datë ____ . ____ 20 __ , _____

¹ Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i Shoqërisë për Sigurim

PYETËSOR PËR ANËTAR TË ORGANIT DREJTUES NË SHOQËRI TË SIGURIMEVE

INFORMACIONE PËR PLOTËSIM TË PYETËSORIT:

Pyetësoni plotësohet personalisht nga personi i cili është i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues në Shoqërinë e Sigurimeve. Personi mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e përgjigjeve të dhëna në Pyetëson. Në mënyrë plotësuese, edhe Shoqëria e Sigurimeve në të cilën personi është i propozuar për Anëtar të Organit Drejtues, është e obliguar të kontrollojë dhe verifikojë përmbajtjen e përgjigjeve të dhëna në Pyetëson, në kuadër të kompetencave të saj dhe aty ku është e mundur.

Rekomandohet që Pyetësoni të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Pyetësonit mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Mbikëqyrje të Sigurimit www.aso.mk. Nëse Pyetësoni nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

Të gjitha pyetjeve të dhëna në Pyetëson duhet t'i përgjigjeni, ndërsa pyetjet të cilat nuk janë të zbatueshme duhet të shënohen në mënyrë përkatëse me "E PAZBATUESHME". Nëse në Pyetëson nuk ka hapësirë të mjaftueshme për përgjigje të detajuar, bashkëlidhur me Pyetësonin është e nevojshme të parashtrohet shtojcë (në formë të shkruar) me numrin e pyetjes të cilës i përket përgjigja.

Personi i cili e plotëson Pyetësonin është i obliguar menjëherë të informojë Agjencinë nëse në çfarëdo kohe pas parashtrimit të Pyetësonit në Agjenci parqitet ndryshim i rëndësishëm i të dhënave të shënuara në këtë pyetëson. Ky është një obligim i vazhdueshëm të cilin e merr personi me nënshkrimin e këtij Pyetësoni.

PJESA 1: TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Emërtimi i Shoqërisë të Sigurimeve në të cilën emërohet personi:

2. Pozicioni/vendi i punës në të cilin emërohet personi:

2.1. Përshkrimi i detyrave të punës të cilat do t'i kryejë personi:

3. Data e fillimit të mandatit të personit në pozicionin në të cilin është emëruar:

4. Personi për kontakt nga Shoqëria e Sigurimeve nga i cili mund të merren të dhëna në lidhje me këtë pyetësor:

4.1. Emri dhe mbiemri:

4.2. Pozicioni në Shoqëri:

4.3. Numri i telefonit:

4.4. Adresa e postës elektronike:

PJESA 2: TË DHËNA PERSONALE

5. Shënoni të dhënat tuaja personale

5.1. Emri dhe mbiemri:

5.2. Adresa e shtëpisë:

5.3. Adresa në RMV (nëse bëhet fjalë për person të huaj me qëndrim në RMV).

5.4. Data dhe vendi i lindjes:

5.5. Shtetësia:

5.6. Numri i letërnjoftimit apo numri i pasaportës (për persona fizikë të huaj):

5.7. Telefoni:

5.8. Adresa e postës elektronike:

PJESA 3: TË DHËNA PËR ARSIMIN

6. Shënoni të dhënat për arsimin e kryer me datën e duhur të kryerjes dhe emërtimin e institucionit arsimor (universiteti/fakulteti) ku është kryer arsimi, në përputhje me kërkesat

Emërtimi i arsimit të kryer (nivele)	Emërtimi i institucionit arsimor	Adresa e institucionit arsimor	Viti i diplomimit

7. Shënoni të dhëna për njohuritë tuaja të gjuhës maqedonase dhe të gjuhëve të tjera të huaja:

7.1. Njohuri të gjuhës maqedone

Gjuhë amtare _____

Shkëlqyeshëm _____

Mirë _____

Dobët _____

7.2. Njohuri të gjuhëve të huaja

Gjuha e huaj	Shkëlqyeshëm	Mirë	Dobët

PJESA 4: TË DHËNA PËR HISTORINË DHE PËRVOJËN PROFESIONALE

Shënim: Shënoni të dhëna të plota për historinë dhe përvojën profesionale. Detyrimisht të shënohen të gjitha periudhat e papunësisë (ndërprerjet në stazhin e punës) dhe arsyet për ndërprerje të sqarohen. Poashtu, duhet të shënohen të dhëna të detajuara për arsyet e braktisjes, gjegjësisht ndërprerje tjetër të vendit të punës.

Pikat 8.1. - 8.6. përsëriten varësisht nga vendet e punës në të cilët ka punuar personi.

8. Shënoni të gjitha vendet e punës dhe/ose funksionet që keni kryer deri në momentin e plotësimit të Pyetësorit, duke përfshirë të dhëna për punëdhënësin, natyrën e punës së tij, pozicionin që keni mbajtur, përshkrim të shkurtër të detyrave që i keni kryer dhe të dhëna të tjera, duke filluar nga vendi i fundit i punës:

8.1. Emrtimi i punëdhënësit dhe natyra e punës së tij (psh. Shërbime financiare, kontabilitet, shërbime juridike, shërbime konsultative etj.):

8.2. Adresa e punëdhënësit:

8.3. Statusi rregullator dhe, nëse është e aplikueshme, emërtimin e organit rregullator:

Institucion rregullator:

PO

JO

Nëse përgjigja është PO, Emërtimin e Organit Rregullator:

8.4. Data e punësimit dhe data e përfundimit të marrëdhënies të punës:

8.5. Pozicioni i punës të cilin e keni mbajtur dhe përshkrim të shkurtër të detyrave të punës:

8.6. Arsyet për ndërprerje të marrëdhënies së punës:

PJESA 5: TË DHËNA PËR ANËTARËSIM NË ORGANE PROFESIONALE DHE ORGANIZATA TË NGJASHME

9. Shënoni të gjitha anëtarësimet në organe profesionale apo organizata të ngjashme, me të dhëna për datën e marrjes së anëtarësimit, në pajtim me kërkesat e dhëna në tabelë:

Emërtimi i organit profesional apo organizatës së ngjashme	Adresa e organit profesional apo organizatës së ngjashme	Data e marrjes së anëtarësimit	Emërtimi i anëtarësimit (themelues, partner, anëtar)

PJESA 6: TË DHËNA PËR KUALIFIKIME TË TJERA TË ARRITURA

10. Shënoni të gjitha kualifikimet e tjera të arritura, së bashku me të dhëna për datën e arritjes së kualifikimit dhe emërtimin e institucionit në të cilin është arritur ai, sipas kërkesave të dhëna në tabelë:

Emërtimi i kualifikimi të arritur	Emërtimi i institucionit në të cilin është arritur kualifikimi	Adresa e institucionit në të cilin është arritur kualifikimi	Data e arritjes së kualifikimit

PJESA 7: TË DHËNA TË TJERA RELEVANTE

11. 1. A jeni ju apo ndonjë person i lidhur me ju, aksionar, pronar, bashkëpronar apo bashkëpunëtor në një person tjetër juridik?

Po

Jo

11.2. Nëse përgjigja është po, plotësoni të dy tabelat e mëposhtme, ku e para plotësohet vetëm për anëtarin e propozuar, ndërsa e dyta për personat e lidhur me personin fizik

Emërtimi dhe selia e personit juridik në të cilin personi fizik ka pjesë të kapitalit dhe/apo të aksioneve me të drejtë vote	Përqindja e kapitalit dhe/apo aksioneve me të drejtë vote

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emërtimi i personit të lidhur	Emërtimi dhe selia e personit juridik në të cilin personi juridik ka pjesë të kapitalit dhe/apo të aksioneve me të drejtë vote	Përqindja e kapitalit dhe/apo aksioneve me të drejtë vote

11.3. A jeni ju apo ndonjë person i lidhur me ju Anëtar i Organit Mbikëqyrës apo Drejtues në personat e përmendur më parë?

Po

Jo

11.4. Nëse përgjigja është po, plotësoni të dy tabelat e mëposhtme, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik, ndërsa e dyta për personat e lidhur me personin fizik.

Emërtimi dhe selia e personit juridik	Organi Mbikëqyrës apo Drejtues

Emërtimi dhe selia e personit juridik	Organi Mbikëqyrës apo Drejtues

11.5. A jeni ju apo personi i lidhur me ju, Anëtar të Organit Mbikëqyrës apo Drejtues apo në çfardo mënyre tjetër realizoni ndikim mbi menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe financave dhe vendimeve afariste të cilitdo person tjetër juridik, përveç personave juridikë nga pika 11.6. e këtij pyetëtori?

Po

Jo

11.6. Nëse përgjigja është po, shënoni ata persona juridikë, Organin Mbikëqyrës apo Drejtues apo mënyrën në të cilën realizoni ndikim.

Emri dhe selia e personit juridik	Organi Mbikëqyrës apo Drejtues	Mënyrë tjetër për realizim të ndikimit

11.7. A jeni ju apo ndonjë person i lidhur me ju, të lidhur me person juridik në të cilin Shoqëria e Sigurimeve në të cilën jeni të propozuar për Anëtar të Organit Drejtues ka pjesë?

Po

Jo

11.8. Nëse përgjigja është po, shënoni personin juridik dhe mënyrën e lidhjes.

11.9. A është hapur procedurë falimentimi ndaj personave juridikë në të cilët keni kryer funksion të personit me të drejta dhe obligime të veçanta?

Po

Jo

11.10. nëse përgjigja është po, shënoni të dhëna më të detajuara për aktivitetet tuaja tek ky person juridik.

11.11. A është miratuar kundër jush vendim i formës së prerë me të cilin është konstatuar përgjegjësia juaj për procedurë të hapur të falimentimit?

Po

JO

11.12. Nëse përgjigja është po, shënoni të gjitha detajet e lidhura me vendimin e gjykatës.

11.13. A janë marrë masa nga Organi kompetent për Mbikëqyrje ndaj Shoqërisë të Sigurimeve apo ndonjë Institucioni tjetër Financiar në të cilin keni pasur pjesë apo keni qenë Anëtar i Organit Mbikëqyrës apo Drejtues apo në çfarëdo mënyre tjetër keni pasur ndikim mbi menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste?

Po

Jo

11.14. Nëse përgjigja është po, shënoni masat dhe të gjitha detajet lidhur me zbatimin e tyre.

11.15. A jeni ju apo personi i lidhur me ju, të lidhur me Anëtarët e tjerë të Organit Drejtues apo Organit Mbikëqyrës të Shoqërisë?

Po

Jo

11.16. Nëse përgjigja është po, shënoni në çfarë mënyre.

11.17. A ka kryer ndonjëherë, ndonjë Organ për Mbikëqyrje të Shoqërive të Sigurimeve dhe Institucioneve të tjera financiare, vlerësim të reputacionit dhe aftësisë tuaj për të fituar pjesë në kapital apo për t'u bërë Anëtar i Organit Mbikëqyrës apo Drejtues të atyre institucioneve?

Po

Jo

11.18. Nëse përgjigja është po, shënoni të gjitha detajet.

Emërtimi i Organit Mbikëqyrës kompetent	Lloji i pëlqimit/lejes të kërkuar	Arsyet, pse pëlqimi nuk është marrë (nëse organi kompetent nuk e ka dhënë pëlqimin e kërkuar)

11.19. A e ka revokuar ndonjëherë ndonjë Organ kompetent i Mbikëqyrjes të Shoqërive të Sigurimeve dhe Institucioneve të tjera Financiare pëlqimin për aksionar apo pjesë në kapital të Shoqërisë të Sigurimeve apo Institucioni tjetër financiar apo e ka revokuar pëlqimin të jeni Anëtar të Organit Mbikëqyrës apo Drejtues,?

Po

Jo

11.20. Nëse përgjigja është po, shënoni të gjitha detajet.

11.21. A është paraparë ndarje e fushave të përgjegjësisë të anëtarëve të Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve?

Po

Jo

11.22. Nëse është paraparë ndarje e fushave, për cilën fushë do të jeni përgjegjës?

11.23. Cilat janë, sipas mendimit tuaj, pikët e forta të Shoqërisë në të cilën jeni propozuar të bëheni Anëtar i Organit Drejtues?

11.24. Si do t'i shfrytëzoni këto pika të forta për forcimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë të Shoqërisë të Sigurimeve?

11.25. Cilat janë, sipas mendimit tuaj, pikët e dobëta të Shoqërisë në të cilën jeni të propozuar të bëheni Anëtar i Organit Drejtues?

11.26. Si do të mënjanoni këto dobësi?

11.27. A mendoni se ekzistojnë fakte dhe rrethana të tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme gjatë vlerësimit të aftësisë tuaj për t'u bërë Anëtar i Organit Drejtues të Shoqërisë të Sigurimeve dhe për të siguruar punë të qëndrueshme dhe të sigurtë të Shoqërisë?

11.28. Përshkruani shkurtimisht, ku e shihni Shoqërinë pas pes viteve?

Unë _____ (emri dhe mbiemri i personit të propozuar për kryerje të funksionit)

a) Deklaroj, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, se informatat që i përmban ky pyetësor, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtroj në kuadër të Kërkesës për dhënie të pëlqimit për Kryerje të Funksionit Anëtar i Organit Drejtues në Shoqëri të Sigurimeve, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara.

b) Jam i/e vetëdijshëm/me për kriteret e përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve të cilët duhet t'i plotësoj që të bëhem Anëtar i Organit Drejtues në Shoqëri të Sigurimeve.

c) Deklaroj, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, se në afat më të shkurtë të mundshëm do të informoj Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve për çdo ndryshim në të dhënat që përfshihen në Kërkesën time dhe në këtë pyetësor.

d) Deklaroj, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, se do të siguroj respektim të standardeve të mbikëqyrjes, do të zbatoj masat e marra nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve dhe do të parashtroj të gjitha të dhënat dhe informatat e kërkuara nga Agjencia për kryerje të mbikëqyrjes efektive, me çka do të siguroj punë të sigurtë dhe të qëndrueshme të Shoqërisë të Sigurimeve.

Emri dhe mbiemri i personit të propozuar për kryerje të funksionit

Numri i letërnjoftimit/pasaportës për të huaj _____

Vendi dhe data

Nënshkrimi i
personit të propozuar për kryerje të funksionit

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË SIGURIMIT



KËRKESË¹
PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR NDRYSHIM TË EMËRTIMIT

1.	Emërtimi i Shoqërisë të Sigurimeve - kërkuessit	
2.	Emërtimi i propozuar i ndryshuar i Shoqërisë të Sigurimeve	
3.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
3.1.	Telefoni i personit të autorizuar për kontakt me Agjencinë	
3.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar për kontakt	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në pajtim me nenin 4 paragrafi (3) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve” siç janë (*qarkohet gjegësisht shënohet nëse plotësohet në mënyrë elektronike*):

1.	Vendim për ndryshim të emërtimit të Shoqërisë të miratuar nga Organi Drejtues kompetent i Shoqërisë për sigurim
2.	Leje nga një Organ kompetent (nëse kërkohet ndryshim i emërtimit të Shoqërisë dhe emërtimi i propozuar i Shoqërisë përmban fjalë për të cilat në pajtim me LSHT është e nevojshme leje paraprake nga një Organ kompetent)
3.	Dëshmi për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për ndryshim të emërtimit, në pajtim me Tarifën e Agjencisë.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me paraqitjen e kësaj Kërkesë Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtroj/më së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për ndryshim të emërtimit janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin bashkangjitur me këtë Kërkesë, do të njoftoj Agjencinë në afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur.

Data dhe vendi i parashtrimit**Nënshkrimi i parashtruesit të Kërkesës²**

Datë ____ . ____ 20 ____ , _____

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i Shoqërisë të Sigurimeve

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË SIGURIMIT



KËRKESË¹
PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR NDRYSHIM TË SELISË

1.	Emërtimi i Shoqërisë të Sigurimeve - kërkues	
2.	Selia e Shoqërisë të Sigurimeve	
3.	Selia e re e propozuar e Shoqërisë të Sigurimeve	
4.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
4.1.	Telefoni i personit të autorizuar për kontakt me Agjencinë	
4.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në pajtim me nenin 5 paragrafi (3) dhe (4) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve” siç janë *(qarkohet gjegjësisht shënohet nëse plotësohet në mënyrë elektronike)*:

1.	Vendim për ndryshim të selisë të Shoqërisë të miratuar nga Organi Drejtues kompetent i Shoqërisë të Sigurimeve
2.	Të dhëna për hapësirat afariste ku do të vendoset selia e re (Marrëveshje për shitblerje, Marrëveshje për qira me të dhëna për vendndodhjen, sipërfaqja dhe të ngjashme) dhe për njësitë organizative të cilat do të funksionojnë në selinë e re (nëse kërkohet ndryshim i selisë së Shoqërisë)
3.	Dëshmi për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për ndryshim të selisë, në pajtim me Tarifën e Agjencisë.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me paraqitjen e kësaj Kërkesë Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtroj/më së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për ndryshim të selisë janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin bashkëlidhur me këtë Kërkesë, do të njoftoj Agjencinë në afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur.

Data dhe vendi i parashtrimit

Datë ____ . ____ 20____, _____

Nënshkrimi i parashtruesit të Kërkesës²

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë për Mbiqëqyrje të Sigurimit www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i Shoqërisë për Sigurim

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË SIGURIMIT



KËRKESË¹
PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR SHOQËRI PËR AUDITIM

1.	Emërtimi i Shoqërisë të Sigurimeve - kërkesit	
2.	Emërtimi i Shoqërisë për auditim	
3.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
3.1.	Telefoni dhe faksi i personit të autorizuar për kontakt me Agjencinë	
3.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në pajtim me nenin 6 paragrafi (3) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve” siç janë (*qarkohet gjegjësisht shënohet nëse plotësohet në mënyrë elektronike*):

1.	Vendim të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë të Sigurimeve për përcaktim të Shoqërisë për Auditim e cila do të kryejë auditim të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë, i cili detyrimisht duhet të përmbajë një dispozitë sipas të cilës, i njëjti do të hyjë në fuqi pasi të marrë pëlqimin nga Agjencia.
2.	Deklaratë të Organit Drejtues kompetent të Shoqërisë të Sigurimeve se Shoqëria e Sigurimeve nuk është person i lidhur me Shoqërinë për Auditim, se Shoqëria e Sigurimeve në tre vitet e fundit nuk ka pranuar asnjë lloj shërbimi këshillues nga Shoqëria për Auditim dhe se Shoqëria për Auditim nuk ka kryer pesë auditime të njëpasnjëshme të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të Sigurimeve;
3.	Deklaratë të personit të autorizuar të Shoqërisë për Auditim se Shoqëria për Auditim ka më shumë se tre vjet përvojë në kryerje të auditimit, se Shoqëria për Auditim nuk është person i lidhur me Shoqërinë e Sigurimeve, se Shoqëria për Auditim në tre vitet e fundit nuk i ka dhënë kurfarë shërbime këshilluese Shoqërisë të Sigurimeve, se Shoqëria për Auditim nuk ka kryer pesë auditime të njëpasnjëshme të Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të Sigurimeve
4.	Vërtetim nga Instituti i Auditorëve të Autorizuar gjegjësisht Këshilli për Avancim dhe Mbikëqyrje të Auditimit se Shoqërisë për Auditim në tre vitet e fundit nuk i janë shqiptuar masa nga Instituti i Auditorëve të Autorizuar gjegjësisht nga Këshilli për Avancim dhe Mbikëqyrje të Auditimit dhe
5.	Dëshmi për kompensim të paguar për dhënie të pëlqimit për shoqëri për auditim, në pajtim me Tarifën e Agjencisë.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me paraqitjen e kësaj Kërkesë Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtror/më së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për shoqëri për auditim janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin bashkangjitur me këtë Kërkesë, do të njoftoj Agjencinë në afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur.

Data dhe vendi i parashtrimit

Datë ____ . ____ 20____, _____

Nënshkrimi i parashtruesit të Kërkesës²

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i shoqërisë të sigurimeve



KËRKESË¹

PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR KRYERJE TË AKTIVITETEVE TË PËRFAQËSIMIT NË SIGURIM NGA BANKA

1.	Emërtimi i bankës - kërkuesit	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
2.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në pajtim me nenin 7 paragrafi (3) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve”² si më poshtë (shënohet secili dokument veçmas):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____
11. _____

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me paraqitjen e kësaj Kërkesë Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtroj/më së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurim nga banka, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin bashkangjitur me këtë Kërkesë, do të njoftojë Agjencinë në afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur.

Data dhe vendi i parashtrimit

Datë ____ . ____ 20____ , _____

Nënshkrimi i parashtruesit të Kërkesës²

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i bankës



KËRKESË¹

PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR INVESTIM DERI NË 10% NGA KAPITALI I SHOQËRISË TË SIGURIMEVE NË NJË VEND ANËTAR TË OECD OSE NË NJË VEND ANËTAR TË BASHKIMIT EVROPIAN

1.	Emërtimi i Shoqërisë të sigurimeve - kërkuesit	
1.1.	Emërtimi i personit juridik në të cilin planifikohet investimi	
1.2.	Lloji i investimit (aksione, pjesë, obligacione, etj.)	
1.3.	Shuma e investimit	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	

Së bashku me Kërkesën është bashkangjitur dokumentacioni në pajtim me nenin 8 paragrafi (3) i “Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrje të pëlqimeve” siç janë (shënohet çdo dokument veçmas):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me paraqitjen e kësaj Kërkesë Deklaroj se të dhënat dhe informatat që përmban kjo Kërkesë, si dhe tërë dokumentacioni të cilin e parashtroj/më së bashku me Kërkesën për dhënie të pëlqimit për investim të Shoqërisë të Sigurimeve më së shumti deri në 10% të kapitalit të Shoqërisë të Sigurimeve në një vend anëtar të OECD ose në një vend anëtar të Bashkimit Evropian, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë Kërkesë, si dhe në dokumentacionin bashkëlidhur me këtë Kërkesë, do të njoftoj Agjencinë në afat prej 3 ditëve të punës nga ndryshimi i ndodhur.

Data dhe vendi i parashtrimit

Datë ____ . ____ 20____ , _____

Nënshkrimi i parashtruesit të Kërkesës²

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë për Mbiqëqyrje të Sigurimit www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, detyrimisht duhet të përdoret stilolaps dhe të shkruhet me shkronja të mëdha.

² Kërkesën e nënshkruan personi i autorizuar i bankës